

## NË EMËR TË POPULLIT

P.nr. 1007/16

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DEVIZIONI PENAL** në përbërje me gjyqtarin e vetëm gjykues Rustem Begolli dhe procesmbajtësen Sanije Troshupa, në lëndën penale kundër të pandehurit A. G. për veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.1 lidhur me par.6 të KPRK\_së, sipas akuzës të PTHDP-së në Prishtinë PP.II.nr. 5848/13 dt. 26.02.2016 duke vendosur lidhur me Kërkesën e PTH në Prishtinë për dhënien e urdhërit ndëshkimor me dt. 12.10.2016, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa e PTHDP-së në Prishtinë PP.II.nr. 5848/13 dt.26.02.2016, dhe kjo gjykatë jep këtë:

### URDHËR NDËSHKIMOR

**A. G.**, nga i ati J. , i lindur më *data e lindjes...*, në D., tani me vendbanim në fshatin K., në afërsi të pompës së derivateve "...", ku edhe jeton, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTORË

**SEPSE:** Me datë 21.08.2013, rreth orës 09:50, në Prishtinë, i pandehuri, me automjetin e markës "Golf" ngjyrë e kaltër, me targa *numri i targave...*, ka qenë i përfshirë në një aksident trafiku, ashtu që në kundërshtim me nenin 150 par. 1 dhe nenit 54 të LSKRK, i njëjti, nga pakujdesia, kur ka arritur në rrugën "V. F.", drejtimi për në Podujevë, ka vënë në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që nuk ka respektuar përparsinë e kalimit të këmbësorëve, dhe me pjesën e përparme anësore të anës së majtë të veturës së tij ka goditur këmbësorin tani të dëmtuarin B. K., i cila në ato momente po kalonte rrugën nga ana e majtë në të djathtë duke shfërtëzuar përparsin e kalimit të cilin tashmë i kishte dhënë shoferi i një automjeti parapra, me ç'rast i dëmtuari ka pësuar lëndime të lehta trupore, si dhe është shkaktuar dëme materiale.

- me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së .

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46, të KPRK, si dhe neneve 365 e 495, të KPP të Republikës së Kosovës, të pandehurit i shqipton:

### DËNIM ME GJOBË

**I pandehuri A. G.** dënohet në shumë prej **200 (dyqind euro) €**, të cilin dënim, është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutojë duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet) € të gjobës.

I pandehuri obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën e komunikacionit shumë prej **40.88 €** dhe ekspertizën mjeko-ligjore në shumë prej **23.60 €**, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumë prej **20 (njëzet) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit B. K., me vendbanim në P., rr."V. F." nr...., ku edhe jeton , për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

## **A R S Y E T I M**

Prokuroria Themelore në Prishtinë me akuzën PP.II. nr.5848 /13 dt. 26.02.2016 e ka akuzuar të pandehurin A. G., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së, dhe njëkohësisht ka kërkuar që ndaj të pandehurit të shqiptohet Urdhëri Ndëshkimor-dënim me gjobë për veprën e cekur penale.

Në kuptim të nenit 493 të KPPRK, parashihet se për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me gjobe ose burgim deri në tre vite, për të cilat prokurori i shtetit është informuar se në bazë të provave të besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkoj me aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor në të cilin do të shqiptoj dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor.

Gjyqtari i vetëm gjykues me rastin e shqyrtimit paraprak të kësaj çështje penale-juridike e duke i vlerësuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: mendimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr. N.U. i dt. 21.01.2016, mendimi i ekspertit të komunikacionit Ing. S. B. i dt. 11.11.2013, fotodokumentacioni si dhe shkresat e lëndës, e aprovoj kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor ku të pandehurin e shpalli fajtor dhe e gjobiti si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues me rastin e shqyrtimit të kësaj çështje penalo –juridike në kuptim të nenit 493 të KPPRK -së gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK- së dhe pranoj Kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor .

Vendimi mbi obligimin e të pandehurit që të paguaj paushallin gjyqësor bazohet me nenin 450 të KPPK-së

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore-juridike u muarr në bazë të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPK së

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**

**P.nr. 1007/16 me dt. 12.10.2016**

**Sekretare Juridike**  
Sanije Troshupa

**Gj y q t a r i,**  
Rrustem Begolli

**KËSHILLA JURIDIKE:** I pandehuri ose mbrojtësi i tij në afat prej 8 ditëve pas pranimit të këtij aktgjykimi-Urdhëri Ndëshkimor, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.